

Leximi së bashku me fëmijën

3-4 vjeç



Bookstart
BookTrust



booktrust.org.uk

 **BookTrust**
Inspire a love of reading

Leximi së bashku, për vetëm 10 minuta çdo ditë:

- **E ndihmon fëmijën të zhvillojë aftësitë shoqërore dhe emocionale**
- **Forcon lidhjen e tyre me ju**
- **I ndihmon të bëhen nxënës me vetëbesim dhe të lumtur.**

Përshëndetje nëna, baballarë dhe kujdestarë!

Ne besojmë që leximi së bashku me fëmijën është një nga mënyrat më të mira për ta përgatitur për shkollë.

Kjo broshurë jep vetëm disa nga këshillat tona të preferuara rreth leximit së bashku me fëmijën – ejani me ne edhe në internet dhe zbuloni më shumë rreth magjisë së leximit të tregimeve, librave dhe vjershave.



www.bookstart.org.uk/have-some-fun

Këshilla që ju ndihmojnë të shijoni librat së bashku çdo ditë



Imitoni kafshët dhe tingujt e tyre - kjo ju ndihmon të futeni në rol dhe do t'ju bëjë të dyve të qeshni!



Rehatohuni të dy bashkë ose thërrisni edhe vëllezërit dhe motrat e tjera për t'i shijuar të gjithë së bashku tregimet dhe vjershat.



Gjatë leximit bëni pyetje të tilla si:
"Çfarë shikon në këtë faqe?"
"Si mendon se ndihen personazhet?"





Lëreni fëmijën të jetë tregimtari. Ata mund t'ju "lexojnë" figurat dhe të flasin për atë që po ndodh në një faqe.



Gjeni një vend të qetë, larg zhurmës, televizorit dhe celularëve.



Nëse ndiheni komod, përpiquni të bëni fytyra qesharake ose të imitoni zërin e personazheve - fëmijët gajasen gjithmonë me këto!



Shikoni figurat dhe filloni të flisni rreth tyre



- A gjeni dot ndonjë dinozaur apo lepur? Çfarë mund të shihni tjetër?
- Sa banane janë aty?
- Çfarë lojërash po luajnë fëmijët?



Sa më shumë që flisni bashkë, aq më shumë fjalë do të mësojë fëmija juaj.

Gjëra për të bërë



Kur dilni së bashku, luani lojë me supozime. Pyeteni fëmijën se çfarë numrash ose germash mund të shikojë në autobusë, postera dhe tabela.



Lëreni fëmijën të argëtohet duke vizatuar në letër me laps ose me shkumës me ngjyrë. Nuk ka mënyrë të saktë apo të gabuar për të vizatuar një pikturë - kjo është faza e parë e shkrimit dhe vizatimit.



Nxiteni fëmijën të bëjë sa më shumë pyetje. Bërja e pyetjeve është një nga aftësitë më të rëndësishme që i duhet një nxënësi!



Po kërkonni më shumë?

- ★ Vizitoni bibliotekën lokale ku mund të merrni falas libra me të drejtë kthimi. Shihni nëse organizojnë mbledhje si “Koha e vjershave” apo “Koha e tregimeve” ku mund të takoheni me familje të tjera dhe të shijoni poezitë së bashku!
- ★ Pyetni mjekun e familjes për ide se si mund ta mbështesni zhvillimin e fëmijës tuaj duke i lexuar librat së bashku.
- ★ Gjeni libra të mirë në internet me “Book Trust”! Ne ju japim shumë ide rreth librave që mund të shikoni në faqen tonë të internetit, duke përfshirë lojëra dhe libra me tregime.



Zgjedhja e librave

“Book Trust” zgjedh libra që ngacmojnë imagjinatën dhe janë argëtues.


Eja me ne në internet për të gjetur rekomandime të pafundme librash fantastikë!

www.bookstart.org.uk/books



Argëtohuni duke gjetur libra të tjerë për t'i lexuar së bashku në faqen tonë të internetit dhe shijoni leximin e librave te paketa “Bookstart”. Është normale të lexoni të njëjtin libër disa herë, pasi librat e njohur janë inkurajues dhe krijojnë vetëbesim.

Ja shembulli i disa librave shumë të mirë që mund të gjeni në “Bookstart Book Finder”!



Duck in the Truck

“ Duck in the Truck arrin gjithmonë të bëjë për të qeshur vajzën time 3-vjeçare. Ajo që e bën kaq shumë të adhurueshëm këtë libër, është kombinimi i vargjeve dëfryese me figurat. Thjesht e adhurojmë! ”

Lexoni së bashku çdo ditë dhe dhurojini fëmijës një dashuri të përjetshme për librat dhe leximin.



Vizitoni **booktrust.org.uk** për të zbuluar më shumë rreth magjisë së leximit të tregimeve, librave dhe vjershave së bashku me fëmijën.

Lexim të mbarë!

Book Trust është një organizatë bamirëse që shërben për të transformuar jetët duke frymëzuar dashurinë për leximin. Ne e dimë se të lexuarit për kënaqësi i ndihmon fëmijët për mbarëvajtjen në shkollë dhe për t'u ndjerë më mirë, prandaj bëjmë çdo gjë që mundemi për t'u siguruar që çdo fëmijë të shijojë tregimet dhe librat.

Shpresojmë që leximi do të bëhet pjesë e rutinës tuaj të përditshme që pritet me padurim nga e gjithë familja.

Numri i ndihmës 313343

booktrust.org.uk

 **BookTrust**
Inspire a love of reading